

N^o 2227, 2226, 2227, 2228

MP A K I
VII
Dosja F

DEKLASIFIKUAR

Radioqram nga Tirana per Moske

d.15/8/1961

MPJ ARKIVI
Viti;
Dosja^{no} Fleta:

SHOKUT GAC MAZI

M O S K E

Njofto urgjentisht Ho Shi Minin:

Komiteti Qendror i Partise Punes Shqiperise, e konsideron te nevojeshme dhe te nguteshme zgjidhjen e mosmarreveshjeve midis udheheqieve te partise te vendeve socialiste te Evropes dhe Partise sone.

Ne konsiderojme se keto mosmarreveshje jane shume te mbedha, shume serioze dhe te thella, dhe se do ish gabim te mejtchej se ato mund te zgjidhen me nje here.

Ne mejtojme se e vetmja rruge zgjidhjeje e ketyre mosmarreveshjeve per te cilat e gjitha pergjegjesia bie mbi udheheqiet e partive te vendeve socialiste te Evropes, sepse ato jane te vetmit shkaketares te tyre, eshte rruga e treguare ne letren e dates 6 korrik 1961 qe Komiteti Qendror i Yni dhe Qeveria jone u kane derguar KQ te P.K. dhe qeverise Sovjetike si dhe gjitha Partive dhe Qeverive te vendeve te kampit Socialist, nder te cilat edhe juve.

Prandaj udheheqia jone mejton se ju, i dashur shoku Ho Shi Min, me pare se te vini ne Tirane per bashkebisedime per keto qesh-tje, do ish mire te bisedonit me te gjitha ato udheheqie qe kane ndermarre veprimtarine e pashembellt jo miqesore dhe anti-marksiste kunder partise, qeverise dhe popullit tone, siq jane: Udheheqia e Bashkimit Sovjetik, Polonise, R.D. Gjermane, Çekoslovakise, Hungarise, Bullgarise dhe Rumanise. Vetem mbasi te behej kjo do te mund te sillnin dobi bashkebisedimet midis jush dhe neve. Natyrisht, nje analize e thelle e shkaqeve dhe pergjegjesive te ketyre mosmarreveshjeve, gjë qe duhet kerkuare jo ne veprimtarine e udheheqies Shqiptare por ne veprimtarine e udheheqieve te partive te vendeve socialiste te Evropes, ne radhe te pare ne ate te udheheqies sovjetike, nuk

19

P. a
Viti
Dosje #

DEKLASIFIKUAR

MPJ ARKIVI
Viti
Dosje #
Fleta:

- 2 -

mund te behet me rrembim. Eshte per keto araye qe Komiteti Qendror i
Yni mejton qe bashkebisedimet midis jush dhe nesh ne Tirane mund te
behen vetem ne pesembedhjete ditorin e dyte te nendorit te ketij viti.
Ky eshte mejtimi perfundimtar i Komitetit Qendror te partise sone mbi
kete ceshtje.

Pershendetje komuniste
Sekretari i pare i Komitetit Qendror te PPSH
Enver Hoxha d.v.

Shoku Gaci,

Ja perktheni mire dhe i a lini tekstin te shkruare. Ja dorezoni
ne qdo ore, qofte dhe naten.

Te gjitha sa te te thote Hoia, degjoi me durim e kujdes dhe na
i njofto. Lere te flase sa me gjate.

15/2/66. D. a. V. C.